

MENDIM PAKICE

Unë, komisioner Lulzim Hamitaj, anëtar i trupit gjykues, nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Robert Kote, me funksionin prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak se subjekti i rivlerësimit, sipas meje, duhej të ishte shkarkuar sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion është mbërritur – nisur nga konstatimi i disa fakteve e rrethanave që lidhen me kriterin e pasurisë, si dhe konstatimeve dhe gjetjeve, në kuadër dhe në raport me informacionet që lidheshin me kriterin e kontrollit të figurës, të ndërthurura këto edhe me çfarë është evidentuar nga analizimi i dosjes profesionale dhe nga përmbajtja e disa prej denoncimeve të publikut – pasi këto fakte, të çmuara së bashku edhe në një vlerësim të përgjithshëm, çojnë në cenimin e besimit të publikut.

Konkretisht, mendoj se vlerësimi i disa rrethanave duhej të ishte i ndryshëm, sikurse edhe çmimi përfundimtar duhej të ishte i ndryshëm – siç analizohet dhe specifikohet në vijim dhe, rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit nuk duhet të ishte konfirmuar në detyrë, pasi nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka rezultuar se:

1. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

- a) Është konstatuar se çmimi i shitjes së automjetit tip “****” shtetasit E. N. në vlerën 4.000 euro pas 3 vjetësh, është disa herë më i lartë se çmimi i blerjes nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 1.000 euro. Komisioni konstaton se nuk ka logjikë ekonomike fakti i shitjes së këtij automjeti me një çmim më të lartë se çmimi i blerjes, me gjithë konsumimin e tij (amortizimi i sendit), ndaj këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare të Komisionit. Subjekti ka dështuar të shpjegojë bindshëm këtë konstatim të Komisionit.
- b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pjesën takuese të pronësisë në pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 61 m² në qytetin e Gjirokastrës.
- c) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shpenzimet e kryera për shkollimin dhe jetesën e vajzës në Vienë dhe nuk i ka deklaruar ato as në deklaratimet periodike vjetore, duke u përpjekur kështu të shmangë verifikimin e mundësive financiare me burime të ligjshme nga organi kompetent lidhur me shumën e shpenzuara me këtë destinacion.
- d) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar një kontratë paraprake nr. ***, të datës 13.2.2017, të nënshkruar me shoqërinë “****” sh.p.k., për blerjen e një ambienti shërbimi me sipërfaqe 68 m² në shumën 45.000 euro, por ka deklaruar marrjen e një kredie në shumën 30.000 euro. Në momentin e nënshkrimit të kontratës me subjektin e rivlerësimit duket se shtetasi/pala shitëse ka qenë në kërkim për një veprër penale, për të cilën është zhvilluar gjykimi në mungesë dhe është deklaruar fajtor/i dënuar. Po ashtu, ka rezultuar se ky shtetas ka pasur edhe disa probleme të tjera me drejtësinë. Gjithashtu, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka përdorur si kolateral për kredinë e marrë në shumën 30.000 euro një pasuri të paluajtshme në emër të një shtetasi tjetër, i cili gjithashtu ka qenë subjekt i hetuar/gjykuar nga sistemi gjyqësor.
- e) Në vlerësim të tërësisë së veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe situatës së rezultuar nga hetimi, krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh, të cilat duket se kanë pasur për qëllim të vetëm marrjen/përfitimin e kredisë bankare në shumën 30.000 euro. Subjekti ka dështuar të shpjegojë bindshëm lidhur me sa më lart.

- f) Nuk jam plotësisht dakord me konkluzionet (nr. 22.5 dhe 22.6 të vendimit), për sa i përket në veçanti shpenzimeve për shkollimin e vajzës së subjektit, jashtë territorit të Shqipërisë, pasi, sipas meje ato duhet të ishin përlllogaritur në një shifër më të lartë, sipas të dhënave të Eurostat-it, sikurse ishin përlllogaritur në rezultatet e hetimit – duke zbritur vetëm periudhat, në të cilat rezultoi se vajza e subjektit kishte qëndruar në Shqipëri. Në këtë mënyrë, nga rishikimi i analizës financiare, në përfundim do të rezultonte një pamundësi financiare me vlerë sigurisht më të lartë se -521.409 – siç është konkluduar në vendim. Kjo pamundësi financiare, gjithsesi, mund të mos mjaftonte për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por kjo rrethanë duhet të mbahet në vëmendje në një vlerësim të përgjithshëm, së bashku me faktin e mosdeklarimit nga subjekti të këtyre shpenzimeve (shkollimi) dhe me problematikat e tjera të përshkruara më sipër, si dhe me konstatimet lidhur me dy kriteret e tjera që do të analizohen në pikat e mëposhtme të këtij mendimi pakice.

2. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

Përgjatë hetimit administrativ, lidhur me një çështje penale për të cilën kishin ardhur *indicie* nga organet ligjzbatuese është konstatuar se: *“Nga rrethanat e vërejtura, duket se prokurori Robert Kote nuk ka bërë një kualifikim të drejtë të veprës penale, e cila ka sjellë për pasojë pushimin e procedimit penal dhe shuarjen e masës së sigurisë, kthimin e automjetit dhe kalimin në favor të shtetit të municioneve luftarake (fishekë) të sekuestruara, për shkak edhe të ligjit për amnistinë”*.

Lidhur me këtë konkluzion i është kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit, i cili paraqiti shpjegime jobindëse në raport me barrën e provës që i ishte kaluar. Në këto kushte, konfirmohet verifikimi i një çështjeje penale të hetuar nga subjekti, për të cilën në përfundim të hetimit ai ka kryer një cilësim të gabuar/lehtësues të veprës penale – duke favorizuar personat nën hetim, për sa kohë ky kualifikim ka mundësuar përfitimin e amnistisë dhe, rrjedhimisht, pushimin e çështjes. Nisur nga këto rrethana, duke i vlerësuar ato në harmoni edhe me *indiciet* e mbërritura pikërisht për këtë çështje, çmohet se ndoshta nuk gjendemi përballë elementeve për të cilat mund të aplikohet neni 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 në raport me figurën – ky fakt kontribuon në cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe do të mbahet në vëmendje në vlerësimin e përgjithshëm të këtij subjekti.

3. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Në vlerësim të pakicës, edhe për sa i përket kriterit të aftësive profesionale – ndonëse nuk janë konstatuar problematika të mjaftueshme që mund të çonin në aplikimin e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 – duhen veçuar disa fakte dhe rrethana, si më poshtë vijon, të cilat, gjithashtu, duhen çmuar nën dritën e jurisprudencës së konsoliduar në vlerësimin e përgjithshëm, në raport me cenimin e besimit të publikut. Konkretisht, gjetjet i referohen çështjes penale të denoncuar nga shtetasi A. D. – procedimi penal nr. ***.

Në përfundim të veprimeve hetimore lidhur me këtë çështje, subjekti ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurit L. K. për veprat penale “vrasje me dashje” kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe “armëmbajtje pa leje”, si dhe në ngarkim të të pandehurit J. K. për veprën penale “përkrahje e autorit të krimit”. Në këtë konkluzion, së pari konstatohet një mangësi konsistence logjike, pasi nuk kuptohet se me kë ka bashkëpunuar shtetasi L. K. për vrasjen me dashje të mbetur në tentativë, për sa kohë të dyshuarit/hetuarit ishin vetëm dy dhe në ngarkim të tjetrit (shtetasin J. K.), vetë subjekti, me të njëjtin akt, ka konkluduar duke cilësuar vetëm veprën penale “përkrahje e autorit të krimit”. Së dyti, është konstatuar një shkelje procedurale lidhur me përdorimin e provave që Gjykata i ka cilësuar të papërdorshme – duke e vesuar kësisoj gjithë procedimin në fjalë.

Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Apelit Tiranë, duke konstatuar se vendimi lidhur me këtë çështje ishte marrë në zbatim të gabuar të ligjit penal material dhe procedural, e ka prishur atë duke e dërguar çështjen për rigjykim me një tjetër trup gjykues. Komisioni i ka kërkuar shpjegime bindëse subjektit në raport me shkakun dhe provat për të cilat ai kishte ndryshuar akuzën, si dhe për përdorimin e provave të papërdorshme.

Subjekti shpjegoi në mënyrë jobindëse, duke pohuar se cilësimi i veprës penale – që Gjykata e gjeti të gabuar – ishte formuluar prej fillimit nga OPGJ-ja dhe ai e kishte miratuar. Ky shpjegim, gjithsesi, konfirmon faktin se subjekti ka çuar për gjykim një akuzë të diferencuar dhe jo në harmoni me faktet dhe alogjike, duke kryer një cilësim të gabuar të veprës penale dhe duke mos e ushtruar funksionin e tij verifikues dhe rregullues lidhur me veprimet apo vlerësimet e gabuara të OPGJ-së – që është thjesht një organ ndihmës dhe jovendimmarrës. Gjithashtu, mbetet e pandryshuar dhe e pashpjeguar bindshëm gjetja lidhur me problematikën e aspektit procedural, në raport me përdorimin e provave të paformuara në respektim të dispozitave ligjore taksative përkatëse, mbi të cilat është mbështetur një konkluzion jo i saktë dhe është kryer një cilësim i gabuar i veprës penale për shtetasin J. K. – më pas të ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Në konkluzion, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, çmoj se faktet dhe rrethanat e përshkruara më lart, të para në tërësinë e tyre, krijojnë bindjen se ato mjaftojnë për të arritur në konkluzionin se subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Për pasojë, në vlerësimin tërësor të çështjes: mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon, në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje, si anëtar në pakicë/kundër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe, për rrjedhojë, në këtë rast gjejnë aplikim pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se vendimi i shumicës së trupit gjykues që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Robert Kote nuk është i drejtë, pasi bazuar në provat që disponon Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe, për rrjedhojë, krijohet bindja se duhet të ishte disponuar shkarkimi i tij nga detyra.

Lulzim Hamitaj
Anëtar/kundër